



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/41

Datë: 06.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në zbatim të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, të Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, të nenit 5 paragrafi 2.4 dhe nenit 10 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, të datës 15 mars 2020 për shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

Për mbrojtjen nga pandemia COVID-19


1. Ndalohet veprimtaria e të gjitha subjekteve afariste dhe bizneseve, qendrave tregtare e rekreative, supermerketeve, subjekteve që ofrojnë shërbimet e gastronomisë (restoranet, kafiterite dhe të ngashme) në tërë territorin e Republikës së Kosovës prej orës 20:00 datë: 06.11.2020 (e Premte) deri më datë: 09.11.2020 (e Hëne) në orën 05:00, përveç:
 - 1.1. Furrave të bukës, barnatoreve, marketeve të vogla, pompave të derivateve;
 - 1.2. Institucionet shëndetësore publike dhe private për nevoja mjekësore, prodhim, furnizim dhe shitje të mallrave esenciale;
 - 1.3. Për shërbime dhe aktivitete që ndërlidhen me menaxhimin e COVID 19 të (menaxhmenti dhe personeli esencial qeveritar dhe komunal nga këta sektorë - shëndetësi, siguri dhe administratë shtetërore);
 - 1.4. Operatorët ekonomik dhe transporti i lirë i mallrave/shërbimeve për të siguruar funksionimin e zingjirit të furnizimit.
2. Pezullohen paragrafet 7, 8, 11, 12, 13, 14, 20 të Vendimit të Qeverisë Nr.01/39 të datës 01.11.2020 deri në kohën e përcaktuar sipas dispozitivit 1. të këtij vendimi.
3. Obligohet Policia e Kosovës të bëjë kontroll rigoroz në zbatim të masave, vendimeve dhe Ligjit Nr.07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë në territorin e Republikës së Kosovës.
4. Për të gjithë shkelësit e këtyre masave, organet kompetente obligohen të shqiptojnë masat ndëshkimore konform Ligjit Nr.07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Pas vendosjes së masave nga Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 01.11.2020, me Vendimin Nr.01/39, me rishikim brenda dy javësh të situatës epidemiologjike, edhe në këtë javë kemi rritje të përshpejtuar të rasteve pozitiv me COVID-19, andaj me qëllim të mbrojtjes së popullatës nga COVID-19 dhe shmangies së levizjeve të qytetarëve, me propozim të Ministrisë së Shëndetësisë, dhe në përputhje me rekomandimet e IKSHPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Inspektorateve
- Policisë së Kosovës
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë